



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

**Nr.324/1Prot**

**Shkodër, më 11.01.2019**

**Lënda: Jepet informacioni i kërkuar**

**Rruga \_\_\_\_\_**

Në vijim të kërkesës suaj nr.14 Prot, datë 07.01.2019, regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr.342 Prot, datë 09.01.2019, në të cilën, bazuar në nenin 8 dhe 10 pika 2 të ligjit nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkonti informacion për numrin total të kërkesave për informacion publik të depozituara dhe atyre të cilave u është refuzuar dhënia e informacionit për periudhëm janar – dhjetor 2018, ju bëjmë me dije se:

Numri i kërkesave për informacion, drejtuar Bashkisë Shkodër gjatë vitit 2018 është 110 (njëqind e dhjetë). Bazuar në nenin 8 të ligjit nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit”, regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është i publikuar tek Programi i Transparenës, në faqen e internetit [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al).

Kërkesë së cilës, i është refuzuar dhënia e informacionit, është ajo me nr.3 tek Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigje, me arsyetimin se informacioni i kërkuar nuk mund të jepej në bazë të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Një tjetër kërkesë, pjesërisht e refuzuar, është ajo me nr.92 tek regjistri, për të cilën kërkuuesi është ankuar pranë Zyrës së Komisionerit. Mbas shkresës së Komisionerit, Bashkia Shkodër ka vënë në dispozicion të kërkuarit dhe pjesën tjetër të informacionit të refuzuar (nr.102 tek regjistri).

Përsa i përket, përditësimit të Programit të Transparenës në përputhje me Programin Model të miratuar me urdhërin nr.211, datë 10.09.2018 të Komisionerit, Bashkia Shkodër e ka përfunduar atë dhe e ka dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak me shkresën nr.20545 Prot, datë 12.12.2018.

Këshilli i Bashkisë Shkodër, në mbështetje të nenit 18 dhe 54 shkronja “k” të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ka njoftuar zhvillimin e seancës së këshillimit me publikun, për diskutimin e projekt aktit “Për miratimin e Programit të Transparenës në Bashkinë Shkodër”, njoftim i cili është bërë në faqen e internetit të Bashkisë Shkodër në

[http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/N\\_J\\_O\\_F\\_T\\_I\\_M\\_per\\_keshillim\\_me\\_publikun\\_12\\_34\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/N_J_O_F_T_I_M_per_keshillim_me_publikun_12_34_1.php). Seancë është caktuar me datë 10 Janar 2019, ora 11.00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Në mbledhjen e rradhës së Këshillit Bashkiak, do të bëhet diskutimi dhe miratimi i Programit të Transparencës, dhe në fillim të muajit përditësimi i tij në faqen e internetit. Gjithësi, Bashkia Shkodër në vazhdimësi ka bërë përditësimin e programit aktual të transparencës.

Duke ju uruar mbarëvajtje në punë

**KRYETAR**

**Voltana ADEMI**